**V E N D I M**
**Nr. 380, datë 14.7.2000**

# PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.358, DATË 28.7.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE TË DOGANAVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8487,datë 13.5.1999, "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës" dhe të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999, "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Zëvendëskryeministrit e ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrve

V E N D O S I:

I. Në vendimin nr.358, datë 28.7.1999, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pagat e punonjësve të doganave rriten 10 për qind.

2. Në fund të pikës "I", shtohen një paragraf me këtë përmbajtje:

a) Paga e drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave bëhet 56 760 lekë në muaj.

b) Paga e zëvendësdrejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave bëhet 40 530 lekë në muaj.

3. Lidhja nr.I, "Struktura e pagës së doganave" dhe Lidhja nr.2, zëvendësohen me lidhjet, me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

II. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen në përputhje me pikën 1, të aktit normativ nr.1, datë 14.7.2000, "Për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga rritja e pagave dhe pensioneve".

III. Vendimi i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**

| KATEGORIA EMËRTIMI | PAGA MUJORE | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E PROFESIONIT | |
| | Paga e Grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi në % | Shtesa për Kuali-fikim në % | Shtesa për Pozicion në lekë | Shtesa për kushte pune në lekë |
| A. Drejtor Drejt. në Departament<br>Drejtor Drejtorie Rajonal | 1 | 2% e PG për çdo vit pune | | 24 739 | 15 466 |
| B. Përgjegjës sektori<br>Kryetar Dege<br>Inspektor | 1 | 2% e PG për çdo vit pune | | 19 606 | 13 690 |
| C1. Specialist, Hetues dogane<br>Drejtues Turni | 1 | 2% e PG për çdo vit pune | | 12 373 | 12 905 |
| C2. Doganier | 1 | 2% e PG për | | 9 747 | 10 944 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | çdo vit pune | | | |
| D1.Doganier,shofer, regjistrues,sekretare,magazinier,operator,laborant. | 3 | 2% e PG për çdo vit pune | | 7 948 | 8 771 |
| D2. Centralist. Sportelist | 3 | 2% e PG për çdo vit pune | | 7 948 | 8 771 |
| Sanitare.Punëtor mirëmbajtje | 4 | 2% e PG për çdo vit pune | | 4 565 | 1 699 |

LIDHJA NR.2

| Grupi | Paga në lekë |
|---|---|
| 1. | 6 600 lekë |
| 2. | 5 500 lekë |
| 3. | 4 950 lekë |
| 4. | 3 300 lekë |